

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DHE AUDITIMET E PERFORMANCËS

nga Klodian GLLAVA – Auditues i lartë,

botuar në gazetën “Tirana Observer”, më 20 maj 2014.



Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (Tetor 2013), thekson se: *Duhet bërë përpjekje për zbatimin në kohë të Strategjisë për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike (ose ndryshe strategjia dixhitale) që duhet të përfundojë deri më 17 qershor 2015. Përpjekje të mëtijshme kërkohen për të liruar spektrin e frekuencave që përdoren në mënyrë të paligjshme (pa licencë).*

Transmetimet numerike tokësore në Shqipëri edhe sot janë të parregulluara, ndërkaq që deri në datën e sipërcituar do të duhet mbyllja e transmetimeve analoge edhe nderpreja e sinjalit, në bazë edhe të Marrëveshjes GE 06, ratifikuar në Kuvendin e Shqipërisë.

Paralelisht, pezullimi i procesit të licencimit të rrjeteve numerike private kombëtare, sipas procedurës “beauty contest”, ka bllokuar të gjithë procesin e kalimit në transmetimet numerike, proces i cili përbën një angazhim ndërkombëtar të shtetit shqiptar.

I konsideruar si një prej projekteve më të rëndësishme edhe kritike në fushën e mediave, kalimi i transmetimeve nga analoge në numerike do të ofrojë për të gjithë shqiptarët 24 kanale televizive kombëtare tematike (*Sport, Edukim, Kulturë, Mjekësi, Parlament*), si edhe akses më të shpejtë drejt teknologjive të reja dhe çmimeve më të ulëta për komunikimet.

Por jo vetëm kaq.

Shqiptarët do të shohin rimëkëmbjen e një institucioni për të cilin paguajnë taksa, rritja e cilësisë do të jetë e prekshme, do të shohin ruajtjen e identitetit dhe trashëgimisë kulturore dhe përmbushjen e objektivit të RTSH-së për t'i shërbyer të gjitha shtresave të popullsisë pa pagesë.

Projekti i Dixhitalizimit të RTSH-së do të financohet nëpërmjet një kredie të butë me terma konkurrues, që do të paguhet nga të ardhurat e gjeneruara nga vetë institucioni. Aftësia paguese e RTSH-së është 4-5 vite (Pay-Back Period). Përqindja e kthimit të Investimit është 45%, çka përbën një normë preferenciale për investimet strategjike dhe sidomos për një institucion publik jofitimprurës. Ky investim është me përfitim me vlera pozitive financiare (NPV>0) dhe i tejkalon kriteret e nevojshme për t'u quajtur i suksesshëm financiarisht.

Edhe në rast se vetë institucionit do t'i duhet të marrë kredi komerciale me interes Euribor + 8%, sërish aftësia e shlyerjes dhe e kthimit të investimit prej 23 milionë euro është e lartë. Prandaj, ajo që do të sillte garancia nga Qeveria Shqiptare është një normë më e ulët interesi (Euribor +2%) ndërsa rrit edhe transparencën e fondeve të institucioneve publike.

Ekonomia shqiptare, kompanitë e telekomunikacionit dhe qytetarët do të kenë përfitime të gjithanshme nga shfrytëzimi i Dividentit Dixhital për shërbime të tjera që do të përfitohet nga lirimi i spektrit të frekuencave (të zëna pa licencë) të cilat mund të ripërdoren dhe shiten në vlera shumë të mëdha (mbi 500 milionë euro, në të njëjtën formë tenderuese që janë shitur licencat 3G).

Por a janë marrë në konsideratë elementët kosto-përfitim, standardet e larta të cilësisë, rreziqet dhe interesat ekonomiko-financiare të Shqipërisë për këtë projekt?

Sigurisht që po!

Qeveria Shqiptare mund të dalë garant i plotë i këtij investimi, duke qenë se RTSH i ka të gjitha kapacitetet dhe garancitë financiare për të përmbushur me sukses këtë projekt.

E megjithatë, kjo garanci financiare mund të jepet vetëm duke u bazuar mbi disa kushte dhe kriteret që janë sa operacionale aq edhe strategjike. Këto kushte, në radhë të parë, përfshijnë kryerjen e një reformimi total të institucionit, sigurisht duke arritur edhe një konsensus politik midis forcave politkberëse në Shqipëri.

Qeverisë, sidoqoftë, do t'i duhet të bëjë një studim të pavarur, makroekonomik dhe financiar, mbi vlerat ekonomike dhe përfitimet që do të vijnë nga kalimi nga transmetimet analoge në ato numerike, ku duhet të merren parasysh efektet mbi ekonominë për një afat kohor 5-8 vjeçar.

Nevojitet menaxhimi efikas i të ardhurave të gjenercara nga vetë RTSH, sipas prioriteteve dhe nevojës dixhitale, krijimi i një pavarësie financiare, rritja e transparencës dhe komunikimit të indikatorëve ekonomiko-financiar, si edhe këshillimi me publikun dhe ekspertët mbi politikat e institucionit.

Do të nevojitet përmbushja e detyrimeve ligjore mbi pagesat e planifikuara për projekte të rëndësishme teknike për futjen e teknologjive të reja të prodhimit dhe transmetimit (Ligji Nr. 3719 Mars 2013, pika c).

I një rëndësie të veçantë për garancinë financiare mbetet edhe realizimi i mbledhjes së tarifës televizive si dhe realizimi i të ardhurave shtesë (reklama, të ardhura nga palë të treta përfshi këtu edhe të ardhurat nga televizionet lokale).

Nuk duhet harruar edhe se RTSH, të paktën deri në vitin 2020, do të transmetojë eventet më të rëndësishme sportive dhe kulturore të cilat duhet të menaxhohen me efikasitet dhe përgjegjshmëri, ndërsa të ardhurat e pritshme nga reklamata apo shitja e këtyre të drejtave nuk duhet t'u kalojnë indirekt televizioneve të tjera në dëm të interesit të RTSH.

Si garanci financiare për qeverinë Shqiptare dhe kompaninë kredituese që do të realizojë projektin mund të shërbejë e ardhura rreth 1.5 milionë euro që RTSH merr çdo vit nga Televizionet Kineze, CRI, VOA, BCC, TWR (Trans World Radio). Tepricat e të ardhurave nga Televizioni Kinez CRI, dhe tarifa e shërbimit për aparatën marrës mund të shërbejnë për të kryer investime të menjëhershëm në dixhitalizimin e arkivës, përmirësimin e prodhimit në dixhital apo krijimtarinë artistike duke fituar pozicionin e një lideri në tregun mediatik.

Në fund të një periudhe 8-10 vjeçare mund ti bëhet një ndarje aktivitetit të prodhimeve të përmbajtjes dixhitale (digital content provider) nga ato të shpërndarjes së përmbajtjes (digital transmission) dhe më pas si rezultat i shitjes së aktivitetit të shpërndarjes RTSH dhe shteti do kishin përfitime financiare që do të sillnin përmirësime të mëtejshme të cilësisë së shërbimit mbi publikun.

Një artikull i Prillit 2014 i HBR thotë se "Leadershipi strategjik nuk është një problem matematikor, një analizë apo eksperiment. Mendimet strategjike duhet të shoqërohen me vendime strategjike. Pavarësisht se analizat kosto-përfitmi janë të mbushura me parashikime dhe skenarë që mund të duken të bukur për vendimmarrësit, janë të pavlefshme në momentin që nuk shoqërohen me vendime për marrjen e masave dhe veprimeve konkrete. Pavarësisht pasigurive të së

ardhmes, kompleksitetit dhe mundësive reale të dështimit, liderët dhe drejtuesit duhet të marrin guximin të marrin vendime për përqendrimin e institucionit dhe grupit të punës” (Pulse, 2014).